



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 421/17 prot.

Tiranë, më 17.03.2023

Lënda: Dërgohet Vendimi Nr. 38, datë 17.03.2023, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Z. Olsi JAZEXHI
TIRANË

Për dijeni: **Znj. Zhaklin LEKATARI**
Rruga "Gjin Bue Shpata", Pall. 19, Shk. 19, Ap. 6,
TIRANË

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë Vendimin Nr. 38, datë 17.03.2023, e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 421 prot.

Tiranë, më 17.03.2023

V E N D I M

Nr. 38, datë 17.03.2023

Bazuar në pikën 11¹, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

K O N S T A T O N:

Mbështetur në nenin 32/1/c të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, ku sanksionohet se, Komisioneri ka kompetencë: "*Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelle të këtij ligji*", nenin 41/2/a të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: "*Procedimi administrativ mund të fillojë me nismën e administratës ose me kërkesën e palëve të interesuara*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni i transmetuar në televizionin Top-Channel², me Urdhërin Nr. 151, datë 30.09.2022, ka filluar procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me shprehjet e përdorura nga shtetasi Olsi Jazexhi në emisionin "Ftesë në 5" të datës 29.09.2022, transmetuar në televizionin Top-Channel. Me të njëjtin objekt ankese, pranë Komisionerit është paraqitur dhe ankesa Nr. 153, datë 03.10.2022, nga znj. Zhaklin Lekatari.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në Nenin 33, pika 7/3 të Ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: "*Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtit subjekt, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankese të vetme.*", me Vendimin Nr. 187, datë 03.10.2022, vendosi bashkimin e ankesës Nr. 153,

¹ Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, personi kundër të cilit është paraqitur ankese, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se personi, kundër të cilit është paraqitur ankese nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankese. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankese, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

² <https://top-channel.tv/video/ftese-ne-5-olsi-jazexhi-ofendon-publikisht-zhakun-bieta-i-fik-mikrofonin-29-shtator-2022-pjesa-2/>

datë 03.10.2022, të paraqitur nga znj. Zhaklin Lekatari, me çështjen e nisur kryesisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me Nr. 151, datë 30.09.2022.

Përsa më lart, Komisioneri ka ndjekur të gjitha procedurat sa i përket shqyrtimit të çështjes në lidhje me shprehjet e përdorura nga shtetasi Olsi Jazexhi në emisionin "Ftesë në 5" të datës 29.09.2022, transmetuar në televizionin Top-Channel.

Bazuar nënin 33/10 të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, në përfundim të procedurës së hetimit, Komisioneri ka dalë me Vendimin nr. 236, datë 29.12.2022, me anë të të cilit ka vendosur:

1. Gjuha e përdorur nga shtetasi Olsi Jazexhi në emisionin "Ftesë në 5", transmetuar në datë 29.09.2022 në Televizionin Top-Channel, përbën diskriminim në formën e "gjuhës së urrejtjes", për shkak të gjinisë.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi shtetasi Olsi Jazexhi, në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, z. Olsi Jazexhi, duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

Në kushtet kur, Komisioneri nuk dispononte asnjë adresë të z. Olsi Jazexhi, mbështetur në nenin 162 "Njoftimi Publik", të Kodit të Procedurave Administrative³, nëpërmjet Njoftimit Publik nr. 94 prot., datë 17.01.2023, publikoi Vendimin nr. 236, datë 29.12.2022, në faqen zyrtare të institucionit,

³ Neni 162, i KPA parashikon shprehimisht se: "1. Njoftimi publik bëhet në këto raste: a) kurpalët janë të panjohura; b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi; c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur; ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji. 2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijani nga ai/ajo, të cilit i drejtohet. 3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni. 4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh. 5. Në rastin e njoftimit të një akti administrativ, teksti i shpallur përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 99, të këtij Kodi, me përjashtim të pjesës arsyetuese. Ai shoqërohet me të dhëna për zyrën, vendin dhe mënyrën e njohjes me përmbajtjen e plotë të aktit administrativ."

si dhe aktet e sipërcituara i afishoi gjithashtu edhe në ambientet e jashtme të godinës, ku KMD ushtron aktivitetin e tij⁴. Pavarësisht se afati ligjor 10-ditor nga data e publikimit dhe afishimit të akteve të sipërcituara, u tejkalua më shumë se 1 muaj, z. Jazexhi nuk pati asnjë reagim ndaj vendimit nr. 236, datë 29.12.2022, të KMD-së, për të kërkuar të distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes, sikurse përcaktohej në pikën 2 të tij.

Ndërkohë që, e kundërta ndodhi me subjektin tjetër ndaj së cilit drejtohej ankesa, i cili ndërmarrti hapa, për heqjen e videos nga të gjitha kanalet e tyre zyrtare dhe jo zyrtare, si dhe u distanca duke e bërë këtë fakt publik në emisionin “Ftesë në 5”, të datës 03.10.2022.

Pas kryerjes së Njoftimit Publik nr. 94 prot., datë 17.01.2023, Komisioneri e konsideron të mirëqenë faktin se z. Jazexhi ka marrë dijeni mbi Vendimin nr. 236, datë 29.12.2022 dhe nuk ka dërguar informacion mbi masat e marra në zbatim të këtij vendimi.

Komisioneri konstaton se z. Olsi Jazexhi, në cilësinë e analistit të ftuar në Top Channel, në emisionin “Ftesë në 5”, të moderatores B.S, të datës 29.09.2022, nuk e ka zbatuar Vendimin e tij nr. 236, datë 29.12.2022 dhe është në shkelje të pikës 11, të nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqittir ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni”.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në pikat 11, 12, 13, shkronja “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Z. Olsi Jazexhi të gjobitet në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
2. Gjoha të derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. Pagesa e kësaj vlere të bëhet pranë çdo banke në llogarinë e thesarit Tiranë, për llogari të: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, NIPT: L02027451K, Kodi: 1091001, Entiteti i Qeverisjes: 1, Distrikti (TDO), Llogaria ekonomike: 7115499.

⁴ Kjo mënyrë njoftimi është ndjekur për njoftimin e z. Jazexhi edhe gjatë procedurës së shqyrtimit të çështjes së nisur me Urdhërin Nr. 151, datë 30.09.2022 të KMD-së.

3. Zbatimi i Vendimit nr. 236, datë 29.12.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni mbi sanksionin, sjell shfuqizimin e tij.
4. Ndjekjen e procedurave të parashikuara në nenin 162 të Kodit të Procedurave Administrative për njoftimin e z. Olsi Jazexhi mbi këtë vendim.

KOMISIONERI

Robert Gajda

Robert GAJDA

